MODELI KOMBËTAR

SHKOLLA ME INTEGRITET

Doracak Praktik për mësimdhënës, prindër dhe nxënës për ndërtimin e një kulture të ndershmërisë, përgjegjësisë dhe mundësive të barabarta




ifa
Institut für
Auslandsbeziehungen

analytica

Initiative for Civil Integration


MODELI KOMBËTAR
"SHKOLLA ME INTEGRITET"

Doracak Praktik për mësimdhënës, prindër dhe nxënës për ndërtimin e një kulture të ndershmërisë, përgjegjësisë dhe mundësive të barabarta

Nga Klasa pa frikë deri te Shoqëria pa korrupsion
Si të ndërtojmë integritet dhe si të njohim,
parandalojmë dhe reagojmë ndaj korrupsionit në shkollë

Shoqata për Hulumtimin e Politikave Analytica Shkup
Organizata e Grave nga Strumica – OGS
Iniciativa për Integrime Qytetare IGI Gostivar

Projekti: Youth for Integrity: Expanding Anti-Corruption Youth Action in North Macedonia (Phase II)

Mbështetur nga ifa/zivik
Ministria Federale Gjermane e Punëve të Jashtme

Shkup, 2026

Titulli
Modeli Kombëtar "Shkolla me Integritet" — Doracak Praktik për mësimdhënës, prindër dhe nxënës për ndërtimin e një kulture të ndershmërisë, përgjegjësisë dhe mundësive të barabarta

Botues
Shoqata për Hulumtimin e Politikave Analytica Shkup
Organizata e Grave nga Strumica — OGS
Iniciativa për Integrime Qytetare IGI Gostivar

Autore
Anabella Dimovska, eksperte

Bashkë-autorë dhe kontribues
Ekipi i Analytica Shkup
Ekipi i IGI Gostivar
Ekipi i Organizatës së Grave — Strumica

Projekti
Youth for Integrity: Expanding Anti-Corruption Youth Action in North Macedonia (Phase II)
Të Rinjtë për Integritet: Zgjerimi i Veprimit Rinor Antikorrupsion në Maqedoninë e Veriut

Mbështetje financiare
Programi Financues ifa / ZIVIK
Ministria Federale Gjermane e Punëve të Jashtme

Kontakt
Analytica Shkup
info@analyticamk.org | www.analyticamk.org

Viti i botimit
Shkup, 2026

Ky Doracak është përgatitur në kuadër të projektit „Youth for Integrity: Expanding Anti-Corruption Youth Action in North Macedonia" („Të rinjtë për integritet: Zgjerimi i veprimit rinor antikorrupsion në Maqedoninë e Veriut"), i cili zbatohet nga Analytica Shkup në partneritet me Iniciativën për Integrime Qytetare **IGI Gostivar dhe Organizatën e Grave nga Strumica, me mbështetjen e Programit Financues ifa / ZIVIK, përmes mjeteve të siguruara nga Ministria Federale Gjermane e Punëve të Jashtme**.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk i pasqyron qëndrimet e Programit Financues **ifa/ZIVIK dhe të Ministrisë Federale Gjermane të Punëve të Jashtme**.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE: SHKOLLA: VENDI I PARË KU MËSOHET INTEGRITETI 9
Ky Doracak në kontekstin e përpjekjeve kombëtare deri më sot 11
SI TA PËRDORNI KËTË DORACAK? 12
MODELI KOMBËTAR SHKOLLA ME INTEGRITET 13
SI NJË SHKOLLË BËHET „SHKOLLË ME INTEGRITET"? 14
1. BAZAT E INTEGRITETIT DHE KORRUPSIONIT 16
1.1 ÇFARË ËSHTË INTEGRITETI? 16
1.1.1 Përkufizimi i integritetit 16
1.1.2 Katër nivelet e integritetit 17
1.1.3 Integriteti kundrejt korrupsionit – dy anë të së njëjtës monedhë 17
1.1.4 Pse shkolla është vendi i parë ku ndërtohet integriteti? 18
2. ÇFARË ËSHTË KORRUPSIONI? Korniza ligjore dhe tipologjia 19
2.1 Përkufizimi i korrupsionit 19
2.2 Nocione kyçe 20
2.3 Llojet e korrupsionit – sipas nivelit 20
2.4 Format e korrupsionit – sipas „ngjyrës" së veprës 21
2.5 Korrupsioni aktiv dhe pasiv 22
2.6 Korrupsioni nuk shprehet vetëm përmes dhënies së parave për shërbim 22
2.7 Çfarë na tregojnë të rinjtë? 23
2.8 Pesë mesazhe kyçe nga hulumtimi 24

PJESA II 25

3. NJOHJA E KORRUPSIONIT – KORRUPSIONI NË PRAKTIKË

(Shembuj mësimesh për orë mësimore) 25

4. INTEGRITETI AKADEMIK 31

4.1 Format e shkeljes së integritetit akademik 31

4.2 Temë e veçantë: Inteligjenca Artificiale (IA) dhe integriteti akademik 32

4.3. Mësime për orë mësimore 33

4.4. Kuiz për nxënës: provo njohuritë e tua:
A është korrupsion? 39

4.5. Kuiz për nxënës: kontroll i integritetit:
Sa integritet ka shkolla juaj? 40

PJESA III 42

5. PERSONI PËR INTEGRITET NË SHKOLLË 42

5.1 Kush mund të jetë Person për Integritet? 42

5.2 Rolet dhe përgjegjësitë 43

5.3 Çfarë NUK është Person për Integritet? 44

5.4 Kushtet për punë efektive 44

5.5 Mbrojtja nga presioni dhe hakmarrja ndaj Personit për Integritet 44

5.6 Propozim: Plani Vjetor i Personit për Integritet 45

5.7 Vetëvlerësimi i Personit për Integritet 45

5.8 Mësim për orë mësimore: kujt i besojmë kur diçka nuk është në rregull? 46

6. KODI PËR DHURATAT NË SHKOLLË 49

6.1 Forma të pranueshme falënderimi 49

6.2 Forma të papranueshme 50

6.3 Detyrimet 50

6.4 Pyetje të shpeshta 51

7. MBROJTJA E SINJALIZUESVE.....52
7.1 Kush është i mbrojtur?.....52
7.2 Mekanizmat e brendshëm të sinjalizimit.....53
7.3 Mekanizmat e jashtëm të sinjalizimit.....53
PJESA IV.....54
8. NGA NXËNËS DERI TE AMBASADOR I INTEGRITETIT.....54
Hapat në rrugën.....54
9. MËSIMDHËNËSI SI AMBASADOR I INTEGRITETIT.....55
9.1 Dilema reale – Si duhet të veprojë mësimdhënësi?.....56
9.2 Mësime për orë mësimore.....56
10. PRINDËRIT SI PARTNERË: Takime tematike:.....60
Takimi 1: A janë mungesat e pajustifikuara formë korrupsioni?.....60
Takimi 2: Si (pa)vetëdijshëm i mësojmë fëmijët për korrupsion?.....61
Takimi 3: Lidhje apo merita? – Rasti me ekskursion Erasmus+.....61
11. PAKTI ZYRTAR ETIK PËR INTEGRITET DHE DREJTËSI.....62
12. DHJETË MESAZHE PËR PRINDËRIT.....63
13. TË RINJTË: KLUBE PËR INTEGRITET DHE AKSIONE GUERILE.....64
13.1 Struktura e klubit.....64
13.2 Kalendari vjetor i aktiviteteve.....65
13.3 Aplikacioni mobil: Zëri kundër korrupsionit.....65
13.4 Betimi i nxënësit për integritet.....65
13.5 Si të rinjtë të njohin dhe të denoncojnë korrupsionin?.....66
Pasojat e mosdenoncimit të korrupsionit.....66

14. KARTA PËR INTEGRITET.....67

PJESA V 68

15. SHKOLLA ME INTEGRITET – SISTEMI 5 YJE.....68
Ku ndodhet shkolla juaj? –
Tre shembuj shkollash brenda sistemit 5 yje.....69

16. RRUGA DREJT SISTEMIT 5 YJE: Nga shtatori deri në qershor.....70

17. REKOMANDIME PËR INSTITUCIONET.....72

Rekomandime për Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) 72

Standarde minimale për realizim 75

Deklarata e mësimdhënësit 76

Deklarata e nxënësit 76

Certifikata për ambasador të integritetit 76

Shabllon për takim tematik me prindër.....77

Burime të dobishme dhe mekanizma sinjalizimi 77

PARATHËNIE: SHKOLLA:

VENDI I PARË KU MËSOHET INTEGRITETI

Korrupsioni më së shpeshti lidhet me prokurimet publike, keqpërdorimet e mëdha financiare ose keqpërdorimin e funksionit publik. Megjithatë, rrënjët e korrupsionit shpesh fillojnë shumë më herët — në situatat e përditshme në të cilat të rinjtë i ndërtojnë vlerat, qëndrimet dhe perceptimet e tyre për atë çfarë është e drejtë dhe çfarë nuk është.

Shkolla është një nga vendet më të rëndësishme ku të rinjtë jo vetëm që fitojnë dije, por edhe formojnë vlerat e tyre jetësore. Mënyra se si funksionon bashkësia shkollore, marrëdhënia mes nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve, respektimi i rregullave, trajtimi i barabartë dhe ndjenja e drejtësisë, ndikojnë drejtpërdrejt në atë se çfarë qytetarësh do të bëhen të rinjtë në të ardhmen.

Nëse të rinjtë dëshmojnë çdo ditë favorizim, zbatim selektiv të rregullave, tolerim të parregullsive ose përdorim të lidhjeve personale për të fituar përparësi, ata gradualisht fillojnë ta pranojnë padrejtësinë si pjesë normale të shoqërisë. Nga ana tjetër, kur shohin transparencë, llogaridhënie, trajtim të barabartë dhe respektim të rregullave, ata mësojnë se integriteti ka vlerë dhe se ndershmëria është themel i suksesit.

Pikërisht për këtë arsye, lufta kundër korrupsionit nuk fillon në gjykata, institucione apo shërbime inspektimi. Ajo fillon në familje, vazhdon në shkollë dhe forcohet përmes pjesëmarrjes aktive të të rinjve në bashkësi.

Gjatë vitit 2025, Analytica realizoi një hulumtim gjithëpërfshirës mes të rinjve të moshës 16 deri 26 vjeç, në kuadër të projektit „Të rinjtë në Maqedoninë e Veriut: Hallka kyçe në ndërtimin e një shoqërie pa korrupsion", mbështetur nga Programi Financues ifa / ZIVIK me mjete të siguruara nga Ministria Federale Gjermane e Punëve të Jashtme. Hulumtimi përfshiu 629 nxënës të shkollave të mesme dhe studentë nga Shkupi, Strumica dhe Gostivari, dhe siguroi njohuri të rëndësishme për mënyrën se si të rinjtë e perceptojnë korrupsionin, përvojat e tyre me praktika të padrejta dhe gatishmërinë e tyre për t'u përfshirë aktivisht në ndërtimin e një shoqërie më të përgjegjshme dhe më transparente.

Gjetjet e hulumtimit treguan se të rinjtë nuk e lidhin korrupsionin vetëm me ryshfetin apo keqpërdorimin e funksionit publik. Përkundrazi, ata e njohin atë edhe në situatat

e përditshme me të cilat përballen në procesin arsimor — favorizimin e nxënësve të caktuar, zbatimin selektiv të rregullave, arsyetimin e pajustifikuar të mungesave, trajtimin e ndryshëm të nxënësve dhe përdorimin e lidhjeve personale për të fituar përparësi. Për të rinjtë, dukuri të tilla përbëjnë shkelje të parimeve të drejtësisë, barazisë dhe integritetit, dhe shpesh përjetohen si forma të sjelljes korruptive.

Pikërisht këto vështrime përbëjnë një nga arsyet themelore për përgatitjen e këtij Doracaku. Qëllimi i tij nuk është të jetë edhe një dokument tjetër teorik që do të mbetet nëpër rafte. Përkundrazi, doracaku është një mjet praktik i menduar për mësimdhënës, prindër, nxënës, drejtues shkollorë dhe shërbime profesionale që duan të kontribuojnë aktivisht në krijimin e një mjedisi shkollor të bazuar në besim, përgjegjësi dhe integritet.

Doracaku përmban shembuj praktikë, studime rasti, aktivitete mësimore të gatshme, ide për takime tematike me prindër, rekomandime për formimin e klubeve nxënëse për integritet, mjete për vetëvlerësim të shkollave dhe rekomandime për avancimin e mëtejshëm të sistemit arsimor.

Doracaku është menduar për t'u zbatuar në mjedise të ndryshme shkollore, përfshirë shkollat multietnike dhe shumëgjuhëshe. Gjatë zbatimit të tij, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet qasjes së barabartë në informacione, aktivitete, organe nxënëse, gara dhe mundësi të tjera, pavarësisht nga përkatësia etnike, gjuha e mësimit, gjinia, statusi social, aftësia e kufizuar apo çdo karakteristikë tjetër personale e nxënësit..

> Integriteti nuk është vetëm një lëndë shkollore.
>
> Integriteti nuk është projekt.
>
> Integriteti nuk është fushatë.
>
> Integriteti është një mënyrë e të menduarit, një mënyrë e të sjellurit dhe një vlerë që ndërtohet çdo ditë.

Besojmë se integriteti nuk mësohet përmes përkufizimeve. Ai mësohet përmes shembullit personal, përvojës dhe praktikës së përditshme. Prandaj, çdo mësimdhënës, çdo prind dhe çdo nxënës ka rol të rëndësishëm në ndërtimin e një shkolle në të cilën rregullat vlejnë njësoj për të gjithë, puna vlerësohet drejtësisht, ndërsa ndershmëria njihet si vlera më e lartë. Vetëm kështu mund të ndërtojmë breza që do të besojnë se suksesi arrihet me dije, punë dhe integritet, e jo përmes privilegjeve, ndikimit dhe përparësive të padrejta.

Ky Doracak në kontekstin e përpjekjeve kombëtare deri më sot

Edukimi antikorrupsion në sistemin arsimor të Maqedonisë së Veriut nuk fillon me këtë Doracak. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Byronë për Zhvillimin e Arsimit, ka zbatuar tashmë disa iniciativa të rëndësishme: Programin për edukim antikorrupsion në shkollat fillore (2012–2014), në bashkëpunim me Qendrën për Komunikime Qytetare dhe me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Norvegjisë, e cila rezultoi me futjen e përhershme të përmbajtjeve antikorrupsion në programin mësimor të Edukatës Qytetare për klasën e shtatë; projektin për edukim antikorrupsion në shkollat e mesme (2019–2021), me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Holandës, i pilotuar në gjashtë shkolla; dhe ligjëratat e shkurtra edukative-krijuese në shkollat fillore (2023), me mbështetjen e IFES-it, të realizuara në 13 shkolla nëpër vend. Këto iniciativa e hapën hapësirën dhe konfirmuan gatishmërinë institucionale për edukim antikorrupsion tek të rinjtë..

Ajo që propozon ky Doracak është një mbindërtim, jo një zëvendësim.

Doracaku „Modeli Kombëtar — Shkolla me Integritet" e plotëson mësimdhënien ekzistuese të temave antikorrupsion në kuadër të Edukatës Qytetare, dhe fut elemente që deri më tani nuk kanë ekzistuar në asnjë projekt të mëparshëm:

- një mekanizëm institucional të përhershëm — Person për Integritet në çdo shkollë, në vend të një vizite apo ligjërate të njëhershme;
- një sistem vetëvlerësimi dhe verifikimi — Sistemi 5 Yje, me kritere të qarta dhe të matshme;
- integrim në Programin Vjetor të Punës së shkollës — edukimi antikorrupsion bëhet aktivitet i rregullt, jo aktivitet i lidhur vetëm me një projekt;
- përfshirje të të gjithë aktorëve — nxënës, mësimdhënës dhe prindër, përmes takimeve tematike të strukturuara;
- shtrirje më të gjerë gjeografike — pilotim i propozuar në 8 rajone planore.

Me këtë qasje, Doracaku nuk konkurron me përpjekjet e deritanishme të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Byrosë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) — por ofron një model konkret për institucionalizimin dhe qëndrueshmërinë e tyre pas përfundimit të financimit të projektit.

SI TA PËRDORNI KËTË DORACAK?

Ky Doracak është shkruar për katër lloje lexuesish të ndryshëm, të cilët nuk kanë nevoja të njëjta. Nuk keni pse ta lexoni nga fillimi deri në fund. Gjeni rolin tuaj më poshtë dhe shkoni drejt e atje.

Roli	Çfarë të lexoni
Nëse jeni mësimdhënës	Lexoni Pjesën I (shkurt, për kontekst), pastaj përqendrohuni te Pjesa II (njohja e situatave) dhe Pjesa IV, Kapitulli 9 (mësimdhënësi si ambasador + 4 mësime). Pjesa III ju duhet vetëm nëse jeni caktuar Person për Integritet.
Nëse jeni prind	Shkoni drejt e te Pjesa IV, Kapitulli 10 (prindërit si partnerë) dhe Kapitulli 6 (Kodi i Dhuratave dhe Pyetjet e Shpeshta). Pjesa tjetër është për kontekst, nuk është e detyrueshme.
Nëse jeni nxënës	Pjesa I (çfarë është integriteti dhe korrupsioni) dhe Pjesa II (situatat në Kapitullin 3, kuizi në 4.4) janë shkruar drejtpërdrejt për ju. Pjesa IV, Kapitulli 13 është për klubin nxënës.
Nëse jeni drejtor / koordinator	E gjithë Pjesa III (korniza institucionale) është kyçe për ju. Shtojcat A dhe C janë për integrim në PVP dhe komunikim me MASH/BZHA.
Nëse jeni përfaqësues i MASH / BZHA / KSHPK	Parathënia, Shtojca A (Modeli Kombëtar) dhe Kapitulli 17 (Rekomandime për institucionet) janë shkruar drejtpërdrejt për ju.

Pasqyrë e shpejtë e strukturës:

- Pjesa I — Bazat (çfarë është integriteti, çfarë është korrupsioni, hulumtimi)
- Pjesa II — Njohja (situata, integriteti akademik, kuiz)
- Pjesa III — Korniza institucionale (Personi për Integritet, Dhuratat, Mbrojtja e sinjalizuesve)
- Pjesa IV — Puna me aktorët (mësimdhënës, prindër, nxënës)
- Pjesa V — Verifikimi (Sistemi 5 Yje)

  Shtojcat — Për institucionet, formularë dhe mjete për përdorim direkt

MODELI KOMBËTAR

SHKOLLA ME INTEGRITET

⭐ ⭐ ⭐ ⭐ ⭐

Çfarë përfaqëson Sistemi 5 Yje?

Ky është sistemi i parë i vetëvlerësimit të integritetit të shkollave në Maqedoninë e Veriut. Çdo yll përfaqëson një arritje konkrete dhe të matshme — jo vetëm një qëllim..

Shkollat që i përmbushin të gjitha 5 nivelet fitojnë statusin zyrtar SHKOLLA ME INTEGRITET — i verifikuar nga MASH dhe KSHPK.

⭐ ⭐ ⭐ ⭐ ⭐ **NIVELI 5 — Aplikacioni Mobil dhe partneriteti me KSHPK**

Aplikacioni mobil i promovuar + takim me KSHPK

⭐ ⭐ ⭐ ⭐ **NIVELI 4 — Java e Integritetit**

Minimum 3 aktivitete publike + mbulim mediatik

⭐ ⭐ ⭐ **NIVELI 3 — Forumi tematik me prindër**

Të paktën 1 takim tematik + Pakti i nënshkruar

⭐ ⭐ **NIVELI 2 — Klubi nxënës për integritet**, *Klub aktiv, 10+ anëtarë, 4+ aktivitete në vit*

NIVELI 1 — Vlerësim transparent

Kritere të shkruara në dispozicion të nxënësve para çdo testi

⭐	⭐ ⭐	⭐ ⭐ ⭐	⭐ ⭐ ⭐ ⭐	⭐ ⭐ ⭐ ⭐ ⭐
Transparenca Kriteret para testit	Klubi i Integritetit Klub aktiv i nxënësve	Prindërit Takim tematik + Pakti	Java e Integritetit 3 aktivitete publike	Partneriteti Aplikacioni mobil + KSHPK

Doracaku është i organizuar sipas këtyre pesë niveleve.

Çdo pjesë ju çon drejt yllit të radhës..

SI NJË SHKOLLË BËHET „SHKOLLË ME INTEGRITET"?

Modeli Kombëtar „Shkolla me Integritet" nuk përfaqëson një aktivitet, projekt apo fushatë të njëhershme. Ai është proces i ndërtimit gradual të një kulture shkollore të bazuar në ndershmëri, përgjegjësi, transparencë dhe mundësi të barabarta. Çdo shkollë mund ta zbatojë gradualisht modelin përmes hapave në vijim:

Hapi	Përshkrimi
1. Vendimi i shkollës	Drejtori dhe organet shkollore e pranojnë përcaktimin për ndërtimin e një shkolle me integritet dhe e përfshijnë këtë përcaktim në planifikimin e tyre strategjik dhe vjetor.
2. Emërimi i Personit për Integritet	Përcaktohet një person që do ta koordinojë zbatimin e modelit, do të ofrojë mbështetje këshilluese dhe do të nxisë kulturën e integritetit në shkollë.
3. Miratimi i Programit Vjetor	Shkolla përgatit dhe miraton një Program Vjetor për aktivitete të lidhura me integritetin, edukimin antikorrupsion dhe ndërtimin e një kulture shkollore të bazuar në besim dhe përgjegjësi.
4. Formimi i klubit nxënës për integritet	Nxënësit përfshihen aktivisht përmes klubeve, debateve, fushatave, edukimit ndërmoshor, iniciativave qytetare dhe aktiviteteve të tjera që promovojnë integritetin.
5. Realizimi i aktiviteteve	Mësimdhënësit, nxënësit, prindërit dhe shërbimet profesionale i realizojnë aktivitetet e parapara në doracak: orë tematike, studime rasti, punëtori, takime me prindër, fushata informuese dhe aksione në shkollë.
6. Vetëvlerësimi	Në fund të vitit shkollor, shkolla e vlerëson zbatimin e vet duke përdorur treguesit dhe mjetet e vetëvlerësimit të përfshira në këtë doracak.
7. Sistemi „5 YJE"	Në bazë të kritereve të përmbushura, shkolla e përcakton nivelin e zhvillimit të saj brenda Modelit Kombëtar „Shkolla me Integritet", përmes Sistemit „5 Yje", i cili përfaqëson mekanizëm për përmirësim të vazhdueshëm, jo vlerësim të njëhershëm.

Integriteti nuk është destinacion – është proces

Çdo hap i realizuar kontribuon në krijimin e një shkolle në të cilën nxënësit ndihen të sigurt, rregullat vlejnë njësoj për të gjithë, puna vlerësohet drejtësisht, ndërsa ndershmëria përfaqëson vlerë themelore të bashkësisë shkollore..



1 BAZAT E INTEGRITETIT DHE KORRUPSIONIT

Kjo pjesë vendos themelin konceptual të Doracakut: çfarë është integriteti, çfarë është korrupsioni, dhe çfarë zbulon hulumtimi i Analytica-s se si të rinjtë i përjetojnë të dyja.

1.1 ÇFARË ËSHTË INTEGRITETI?

Ky Doracak mban titullin Shkolla me Integritet. Prandaj, para se të flasim për korrupsionin — format, shkaqet dhe pasojat e tij — duhet së pari të kuptojmë çfarë ndërtojmë në të vërtetë. Integriteti nuk është mungesa e korrupsionit. Ai është diçka shumë më tepër: një mënyrë veprimi, të menduari dhe vendimmarrjeje që është konsistente pavarësisht nëse dikush po shikon.

> Integriteti është ajo që bën kur askush nuk shikon.
> Korrupsioni është ajo që bën kur mendon se askush nuk do ta zbulojë.

1.1.1 Përkufizimi i integritetit

Fjala „integritet" vjen nga latinishtja integritas — tërësi, pandashmëri. Person me integritet është personi vlerat, fjalët dhe veprimet e të cilit janë në pajtim me njëri-tjetrin — pavarësisht nëse vepron para publikut apo vetëm, nën presion apo në situatë të qetë..

Integriteti do të thotë:

- përputhje mes asaj që thua dhe asaj që bën;
- ndershmëri edhe kur ndershmëria sjell kosto;
- përgjegjësi për veprimet dhe vendimet e veta;
- drejtësi në trajtimin e të gjithë njerëzve, pavarësisht lidhjeve apo statusit;
- guxim për t'u kundërvënë padrejtësisë, edhe kur kjo është e pakëndshme.

1.1.2 Katër nivelet e integritetit

Integriteti nuk është një nocion abstrakt i rezervuar për të rritur apo institucione. Ai ekziston në disa nivele, të cilat lidhen mes tyre dhe ndërtohen njëri mbi tjetrin:

Niveli	Përshkrimi
Integriteti personal	Përputhja mes vlerave dhe veprimeve të individit. Shembull: nxënës që nuk kopjon edhe kur askush nuk shikonsepse dëshiron të dijë se suksesi është rezultat i punës së tij.
Integriteti akademik	Ndershmëri në procesin e mësimit dhe vlerësimit — pa kopjim, plagjiaturë apo paraqitje të rreme të dijes. Zhvillohet më në detaje në Pjesën II.
Integriteti shkollor	Kulturë kolektive në të cilën i gjithë bashkësia — nxënës, mësimdhënës, prindër, drejtues — vepron në mënyrë të drejtë dhe transparente. Matet përmes Sistemit 5 Yje.
Integriteti shoqëror	Kur institucionet funksionojnë në mënyrë transparente dhe me përgjegjshmëri ndaj qytetarëve. Shkolla me integritet është hapi i parë drejt këtij niveli më të gjerë.

1.1.3 Integriteti kundrejt korrupsionit — dy anë të së njëjtës monedhë

Ky Doracak flet edhe për integritetin, edhe për korrupsionin, sepse njëra nuk mund të kuptohet plotësisht pa tjetrën. Megjithatë, është e rëndësishme të mbahet mend rendi i të menduarit:

> **Nuk ndërtojmë shkollë pa korrupsion vetëm duke e ndëshkuar atë.**
>
> Ndërtojmë shkollë me integritet duke e praktikuar atë çdo ditë.
>
> Korrupsioni është ajo prej së cilës largohemi. Integriteti është ajo drejt së cilës synojmë.
>
> Ky Doracak orientohet mbi të gjitha drejt të dytit.

1.1.4 Pse shkolla është vendi i parë ku ndërtohet integriteti?

Fëmijët nuk mësojnë për integritetin vetëm përmes përkufizimeve në libër. Ata mësojnë përmes përvojës së përditshme — përmes mënyrës se si vepron mësimdhënësi kur askush nuk pret që të jetë i drejtë, përmes faktit nëse rregullat vlejnë njësoj për të gjithë, përmes faktit nëse puna e nxënësve vlerësohet me të vërtetë.

Prandaj roli i shkollës nuk është vetëm ta „mësojë" temën integritet si pjesë e programit mësimor. Roli i shkollës është të jetë hapësirë në të cilën integriteti praktikohet çdo ditë — përmes mënyrës së vlerësimit, përmes marrëdhënies mes nxënësve dhe mësimdhënësve, dhe përmes mënyrës si zgjidhen konfliktet.

2 ÇFARË ËSHTË KORRUPSIONI?

Korniza ligjore dhe tipologjia

Tani që e dimë çfarë ndërtojmë — integritetin — është e rëndësishme të kuptojmë edhe çfarë parandalojmë. Para se të njohim korrupsionin në shkollë dhe të reagojmë ndaj tij, duhet të kuptojmë: çfarë është saktësisht korrupsioni, cilat janë format e tij dhe pse jo çdo veprim jo-etik përbën automatikisht vepër penale.

2.1 Përkufizimi i korrupsionit

Termi „korrupsion" rrjedh nga termi latin corrupcio, i cili përkthehet si ryshfetdhënie, prishje dhe shpërbërje. Në legjislacionin e Maqedonisë së Veriut, korrupsioni përkufizohet në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave:

> **PËRKUFIZIMI LIGJOR -** Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave
>
> Nën korrupsion nënkuptohet keqpërdorimi i funksionit, detyrës zyrtare apo pozitës me qëllim realizimin e përfitimit personal — drejtpërdrejt ose përmes ndërmjetësit — për vete ose për dikë tjetër.

Tre elemente duhet të jenë njëkohësisht të pranishme që të bëhet fjalë për korrupsion:

Elementi	Kuptimi
Keqpërdorimi	Personi e tejkalon ose e shfrytëzon pozitën zyrtare në mënyrë të kundërt me ligjin ose moralin.
Funksioni / detyra / pozita	Kryesi duhet të jetë mbajtës i ndonjë roli publik, zyrtar apo të besuar — mësimdhënës, drejtor, anëtar komisioni.
Përfitimi personal	Realizohet përfitim — material ose jomaterial — për vete, për të afërm, për mik ose për palë të tretë.

2.2 Nocione kyçe

Për të kuptuar drejt korrupsionin në kontekstin arsimor, është e rëndësishme të njihen nocionet në vijim:

Nocioni	Kuptimi
Detyra zyrtare	Tërësia e detyrimeve që rrjedhin nga kryerja e një funksioni apo profesioni të caktuar. Shembull: mësimdhënësi ka detyrim t'i vlerësojë nxënësit sipas kritereve paraprakisht të njohura dhe të barabarta.
Përfitimi	Çdo lloj dobie materiale ose jomateriale — para, dhuratë, shërbim, avancim, notë.
Rreziku nga korrupsioni	Situatë ose veprim që krijon mundësi për sjellje korruptive, edhe pse kjo ende nuk ka ndodhur.
Konflikti i interesave	Gjendje kur zyrtari ka interes privat që ndikon ose mund të ndikojë në kryerjen e paanshme të detyrës së tij. Shembull: drejtor që është në komision punësimi, ndërsa aplikon fëmija i tij.
Nepotizmi	Favorizimi i të afërmve gjatë punësimit, vlerësimit apo dhënies së privilegjeve.
Kronizmi	Favorizimi i miqve të ngushtë — i ngjashëm me nepotizmin, por bazuar në miqësi, jo lidhje gjaku.
Klientelizmi	Mundësimi i privilegjeve për individë për shkak të besnikërisë politike, partiake apo personale.

2.3 Llojet e korrupsionit – sipas nivelit

Korrupsioni nuk është një dukuri monolite. Në varësi të asaj se kush e kryen dhe çfarë pasojash shkakton, dallojmë tri lloje:

Lloji	Kush e kryen?	Format dhe pasojat
Korrupsioni i lartë	Mbajtës: politikanë, ministra, drejtues institucionesh	Miratim ligjesh në favor të individëve; keqpërdorim i fondeve publike; blerje sistematike ndikimi. Dëmi është masiv dhe afatgjatë.
Korrupsioni i mesëm	Mbajtës: zyrtarë të nivelit ekzekutiv — drejtorë shkollash, anëtarë komisionesh.	Manipulim me procedura punësimi, prokurime publike, ndarje burimesh. Dëmi është institucional.
Korrupsioni i ulët	Mbajtës: mësimdhënës, punonjës administrativë, zyrtarë sporteli.	Vlerësim jo i drejtë, mungesa të pajustifikuara, ryshfet i vogël. Më i afërt me përvojën e nxënësve.

2.4 Format e korrupsionit — sipas „ngjyrës" së veprës

Jo çdo sjellje korruptive apo joetike është vepër penale. Ky është një dallim i rëndësishëm për nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit. Dallojmë tri lloje korrupsioni:

KORRUPSIONI I ZI — vepër e ndjekshme penalisht

Përfshin vepra të rënda penale: ryshfet, mashtrim, përvetësim i mjeteve publike, diploma të rreme. Kryesit i nënshtrohen procedurës penale dhe dënimeve.

Shembull në arsim: mësimdhënës që merr para për t'i vendosur paraprakisht pyetjet e njohura në test; drejtor që përvetëson mjete nga fondi shkollor.

KORRUPSIONI GRI — në kufi të ligjit

Përfshin nepotizmin, kronizmin dhe klientelizmin. Mund të jetë edhe e ndëshkueshme si kundërvajtje. Publiku nuk është i sigurt nëse është e dënueshme apo jo, gjë që e bën veçanërisht të rrezikshme.

Shembull në arsim: drejtor që punëson fëmijën e vet pa procedurë transparente; komision që gjithmonë i zgjedh të njëjtët nxënës për projekte pa kritere publike.

KORRUPSIONI I BARDHË — shoqërisht i tolerueshëm, por problematik

Sjellje që për shkak të zakoneve kulturore nuk konsiderohen imorale dhe nuk sanksionohen ligjërisht — por prapëseprapë i shkelin parimet e drejtësisë dhe integritetit.

Shembull në arsim: prindërit sjellin një dhuratë të vogël për mësimdhënësin pa ndonjë arsye të veçantë.

Pse është problem? Edhe pse individualisht nuk ndëshkohet, korrupsioni i bardhë e normalizon logjikën se duhet të japësh diçka për të marrë trajtim. Kjo gradualisht i fshin kufijtë dhe hap hapësirë për forma më serioze.

2.5 Korrupsioni aktiv dhe pasiv

Një dallim tjetër i rëndësishëm për të kuptuar situatat korruptive:

Lloji	Përshkrimi dhe shembulli
Korrupsioni pasiv	Zyrtari kërkon, merr ose pranon përfitim. Shembull: mësimdhënës që pranon dhuratë të shtrenjtë dhe pastaj e përmirëson notën.
Korrupsioni aktiv	Personi premton, ofron ose jep përfitim për të marrë shërbim. Shembull: prind që sjell dhuratë me qëllim që të ndryshohet nota.

E rëndësishme: Të dyja palët — dhënësi dhe marrësi — mund të mbajnë përgjegjësi. Korrupsioni nuk është njëdrejtimësh.

2.6 Korrupsioni nuk shprehet vetëm përmes dhënies së parave për shërbim

Hulumtimi i Analytica-s[1] me 629 të rinj tregoi se të rinjtë kanë kuptim dukshëm më të gjerë të korrupsionit sesa dhënia e parave për shërbim. Ata i njohin format e mëposhtme të sjelljes korruptive në arsim:

1 Të rinjtë dhe korrupsioni (Qëndrime, përvoja dhe propozime për ndryshim), 2025, Analitika Shkupi. E disponueshme në: https://www.analyticamk.org/mk/studii-za-politiki

- Përmirësim notash për shkak të lidhjeve personale apo presionit të prindërve
- Mbyllja e syve — zbatimi i rregullave vetëm për nxënës të caktuar
- Arsyetimi selektiv i mungesave pa dokumentacion
- Përzgjedhje e padrejtë e nxënësve për gara, projekte dhe programe
- Blerje diplomash apo certifikatash (30% e të anketuarve kanë qenë dëshmitarë)
- Nepotizëm dhe favorizim gjatë ndarjes së bursave dhe çmimeve

> Çdo padrejtësi përbën shkelje të integritetit.
> Ky konstatim tregon se ndërtimi i kulturës së integritetit duhet të fillojë shumë më gjerë se lufta klasike kundër ryshfetit.

2.7 Çfarë na tregojnë të rinjtë?

Në vitin 2025, Analytica realizoi një hulumtim me 629 të rinj (16–26 vjeç) nga Shkupi, Strumica dhe Gostivari, për përvojat e tyre me korrupsionin dhe integritetin në arsim.

Rezultatet e hulumtimit me të rinjtë tregojnë sa vijon:

%	Përshkrimi
54%	janë përballur me korrupsion në arsim
30%	kanë qenë dëshmitarë të blerjes së diplomave dhe certifikatave
21.3%	kanë qenë dëshmitarë të favorizimit të nxënësve ose studentëve
24.3%	kanë qenë dëshmitarë të ryshfetit për marrjen e notave
69.6%	humbin besimin se puna shpërblehet
70%	thonë se tema trajtohet dobët në mësimdhënie
61.7%	mendojnë se të rinjtë emigrojnë për shkak të korrupsionit në vend
47.5%	nuk pajtohen fare me pohimin se institucionet në vend luftojnë aktivisht kundër korrupsionit
51%	do të sinjalizonin, nëse ekziston një mënyrë e sigurt
52.6%	u përgjigjën se korrupsioni prek njëlloj të dyja gjinitë
19.2%	mendojnë se gratë janë më të ekspozuara ndaj korrupsionit

„Korrupsioni është vjedhës i jetëve tona."
— deklaratë e një pjesëmarrësi të ri në hulumtim

2.8 Pesë mesazhe kyçe nga hulumtimi

- Të rinjtë kanë një kuptim më të gjerë të korrupsionit sesa institucionet — për ta kjo është edhe favorizim, arsyetim selektiv mungesash dhe nepotizëm, jo vetëm ryshfet.
- Korrupsioni nuk krijon vetëm padrejtësi — ai krijon të rinj të demotivuar që pushojnë së besuari se puna sjell rezultat.
- 30% e të rinjve kanë qenë dëshmitarë të blerjes së diplomave apo certifikatave — shenjë se sistemi është nën presion të dukshëm.
- Të rinjtë nuk janë vëzhgues pasivë. Më shumë se gjysma do të sinjalizonin një parregullsi nëse ekziston një mekanizëm i sigurt dhe anonim.
- Problemi nuk është mungesa e vullnetit tek të rinjtë — problemi është mungesa e kanaleve të sigurta dhe e besimit në sistem..

MBAANI MEND

📌 **Mbaje mend**

✓ Korrupsioni nuk është vetëm ryshfet — ai është edhe favorizim, nepotizëm dhe zbatim selektiv i rregullave.

✓ Jo çdo sjellje joetike është vepër penale — ekziston edhe korrupsion gri dhe i bardhë.

✓ Tre elemente duhet të jenë të pranishme: keqpërdorim + funksion + përfitim personal.

✓ Integriteti është parandalimi më i mirë — jo dënimet, por vlerat.

3 NJOHJA E KORRUPSIONIT -

KORRUPSIONI NË PRAKTIKË (SHEMBUJ MËSIMESH PËR ORË MËSIMORE)

Kjo pjesë ofron mjete praktike për njohjen e korrupsionit dhe të shkeljeve të integritetit në situata reale shkollore — përmes shembujve konkretë, në vend të përkufizimeve abstrakte.

Çdo situatë është shënuar me ngjyrë sipas rëndësisë dhe shoqërohet me një reagim konkret të rekomanduar. Njohja është hapi i parë — reagimi është hapi tjetër.

⛔ KORRUPSION	⚠ RREZIK PËR SHKELJE TË INTEGRITETIT	✓ NUK ËSHTË KORRUPSION
Shkelje e qartë — reagim formal i nevojshëm	Zonë kufitare — kërkon vëmendje dhe transparencë	Veprim legjitim — pa shkelje

A) Vlerësim i padrejtë

Statusi	Situata	Reagimi i rekomanduar
⛔ KORRUPSION	Mësimdhënësi e përmirëson notën e Emës pasi babai i saj, këshilltar komunal, e thërret drejtorin "vetëm për të biseduar".	*Ankesë me shkrim drejtuar Këshillit të Mësimdhënësve; kërkesë për rivlerësim nga komisioni.*
⛔ KORRUPSION	Të njëjtat rregulla vlejnë ndryshe: disa nxënës marrin vërejtje për vonesë, ndërsa mësimdhënësi nuk u thotë asgjë të tjerëve.	*Këshilli i nxënësve kërkon debat publik dhe kritere të shkruara në dispozicion për të gjithë.*
⚠ RREZIK PËR SHKELJE TË INTEGRITETIT	Nxënësi merr notën 5 pa arsyetim të qartë — nota nuk përputhet me rezultatet e mëparshme.	*Prindërit kërkojnë me shkrim arsyetim; në rast refuzimi — ankesë tek Këshilli i Mësimdhënësve.*
✓ NUK ËSHTË KORRUPSION	Mësimdhënësi i jep detyra shtesë një nxënësi që ka mbetur prapa për shkak të sëmundjes.	*Kjo është mbështetje legjitime pedagogjike. Nuk nevojitet asnjë reagim.*

B) Mungesa të pajustifikuara		
Statusi	Situata	Reagimi i rekomanduar
⛔ **KORRUPSION**	Kujdestari i klasës i arsyeton mungesat e Bojanit pa asnjë dokument — vetëm sepse "kështu është më mirë për të gjithë".	*Rishikim i ditarit; kërkesë për dokumentacion; në rast refuzimi — ankesë drejtuar Këshillit të Mësimdhënësve.*
⛔ **KORRUPSION**	Drejtori i pëshpërit mësimdhënësit: "Mos bëj problem me ato mungesa" — duke iu referuar një fëmije me prind me ndikim.	*Dokumentim i fshehtë i bisedës; sinjalizim tek Sindikata e Pavarur për Arsim, Shkencë dhe Kulturë*
⚠ **RREZIK PËR SHKELJE TË INTEGRITETIT**	Ekziston fletë mjekësore për një numër të caktuar mungesash, por mësimdhënësi arsyeton edhe orët shtesë që nuk mbulohen nga fleta.	*Politikë e qartë për mungesat në Programin Vjetor — e zbatuar njësoj për të gjithë.*

🤝 C) Favorizimi dhe nepotizmi		
Statusi	Situata	Reagimi i rekomanduar
⛔ KORRUPSION	Komisioni ia ndan bursën një kandidati me rezultate më të dobëta — xhaxhai i të cilit është anëtar i Këshillit të Shkollës.	*Kërkim i dokumentacionit të pikëzimit; ankesë tek Inspektorati Shtetëror Arsimor.*
⛔ KORRUPSION	Për Erasmus+ udhëtojnë gjithmonë të njëjtët nxënës — pa thirrje publike, pa kritere, pa arsyetim.	*Kërkesë me shkrim për publikimin e kritereve para çdo zgjedhjeje të ardhshme.*
⛔ KORRUPSION	Kryetari i këshillit të nxënësve emërohet nga drejtori — zgjedhjet nuk janë mbajtur kurrë.	*Peticion për zgjedhje të jashtëzakonshme me votim të fshehtë dhe vëzhgues të jashtëm.*
⛔ KORRUPSION	Nxënës që flet shkëlqyeshëm maqedonisht, por vjen nga një bashkësi tjetër etnike, sistematikisht nuk ftohet në aktivitete shtesë dhe gara, ndryshe nga shokët e klasës.	*Ankesë me shkrim tek Personi për Integritet dhe drejtori; kërkesë për kritere të qarta, kombëtarisht/ gjuhësisht neutrale për pjesëmarrje në të gjitha aktivitetet.*
⚠ RREZIK PËR SHKELJE TË INTEGRITETIT	Nxënës me lidhje të forta familjare nuk merr masa pas incidentit të kryer (dhunë ndaj një nxënësi tjetër) — rasti "zgjidhet në heshtje".	*Sinjalizim tek Ambasada e Parë e Fëmijëve Measi, Inspektorati Shtetëror Arsimor dhe Qendra për Punë Sociale. Kërkesë për hartim të planit për qasje dhe përfshirje; Sinjalizim tek Personi për Integritet nëse përjashtimi vazhdon.*
⚠ RREZIK PËR SHKELJE TË INTEGRITETIT	Shkolla publikon thirrje për pjesëmarrje në projekt ndërkombëtar vetëm në një gjuhë mësimi. Nxënësit e paraleleve që ndjekin mësim në gjuhë tjetër marrin vesh për thirrjen pasi afati ka kaluar.	*Të gjitha thirrjet shkollore të publikohen njëkohësisht në gjuhët e mësimit që përdoren në shkollë. Kriteret, afatet dhe mënyra e zgjedhjes duhet të jenë barabartë në dispozicion për të gjithë nxënësit.*

💰 D) Presioni komercial		
Statusi	Situata	Reagimi i rekomanduar
⛔ KORRUPSION	Mësimdhënësja mëson në mënyrë të paqartë dhe të pakuptueshme në orë, dhe pastaj ofron orë private me pagesë.	*Këshilli i prindërve reagon tek Këshilli i Shkollës dhe inspektorati me shembuj konkretë.*
⛔ KORRUPSION	"Pa librin tim nuk do të merrni notë kaluese për lëndën" — mësimdhënësja ndalon fotokopjet dhe kërkon blerjen e librit të saj.	*Sinjalizim anonim tek drejtori me prova (mesazhe, dëshmitarë).*
⚠ RREZIK PËR SHKELJE TË INTEGRITETIT	Prindërit organizojnë blerjen e një dhurate kolektive të shtrenjtë për mësimdhënësen.	*Zbatoni Kodin për Dhuratat (Pjesa III). Mësimdhënësja duhet ta refuzojë publikisht.*
✓ NUK ËSHTË KORRUPSION	Nxënësi sjell lule për mësimdhënësen në fund të vitit, me iniciativë personale — pa asnjë qëllim.	*Gjest simbolik falënderimi. Nuk ka shkelje.*

🏛 E) Korrupsioni institucional		
Statusi	Situata	Reagimi i rekomanduar
⛔ KORRUPSION	Pyetjet e testit janë të disponueshme paraprakisht vetëm për disa nxënës — përmes një grupi privat.	*Anulim i testit; protokolle për siguri digjitale; procedurë disiplinore.*
⛔ KORRUPSION	Drejtori e hap holin e shkollës për ngjarje partiake — falas, pa vendim të Këshillit.	*Sinjalizim tek KSHPK me dokumentacion foto/video. Hapësira publike nuk është burim partiak.*
⛔ KORRUPSION	Shkolla mbledh para "për fond" në para të gatshme — pa faturë, pa listë, pa llogaridhënie.	*Prindërit kërkojnë raport financiar zyrtar. Në rast refuzimi — Sinjalizim tek Inspektorati Shtetëror Arsimor.*

F) Korrupsioni në shëndetësi dhe prokurime publike		
Statusi	Situata	Reagimi i rekomanduar
⛔ KORRUPSION	Pacienti pret muaj me radhë në listë për operacion — por pas një pagese joformale për kirurgun, operacioni caktohet për javën tjetër.	*Sinjalizim tek Ministria e Shëndetësisë dhe KSHPK. Lista e pritjes duhet të jetë publike dhe e matshme.*
⛔ KORRUPSION	Kompani farmaceutike u ofron mjekëve udhëtime të shtrenjta dhe "bonus" në para nëse i përshkruajnë barnat e saj.	*Sinjalizim tek Oda e Mjekëve dhe KSHPK. Mjeku duhet t'i deklarojë të gjitha lidhjet me industrinë.*
⚠ RREZIK PËR SHKELJE TË INTEGRITETIT	Familja sjell dhuratë të shtrenjtë për kirurgun pas operacionit të suksesshëm — nga falënderimi, pa marrëveshje paraprake.	*Mjeku duhet ta refuzojë ose ta sinjalizojë. Dhurata pas shërbimit është zonë gri — normalizon praktikë të keqe.*
✓ NUK ËSHTË KORRUPSION	Spitali publikon listat e pritjes online dhe i përditëson rregullisht.	*Kjo është transparencë — pikërisht ashtu duhet të funksionojë shëndetësia publike.*
⛔ KORRUPSION	Tenderi për pajisje rentgeni është shkruar me kushte teknike specifike që i plotëson vetëm një kompani e paracaktuar.	*Kërkim i dokumentacionit të tenderit; sinjalizim tek Komisioni Shtetëror për Prokurimet Publike dhe KSHPK.*
⛔ KORRUPSION	E njëjta firmë ushqimi e fiton kontratën me konviktin studentor 7 vjet me radhë — ofertat e konkurrentëve më të lirë gjithmonë diskualifikohen për shkak formal.	*Kërkesë për rishikim të procedurës; sinjalizim tek Enti Shtetëror i Revizionit me dokumentacion.*
⛔ KORRUPSION	Kryetari i komunës lejon ndërtimin e një objekti në lokacion të mbrojtur — pasi investitori ka financuar fushatën partiake.	*Sinjalizim tek KSHPK dhe inspektorati lokal me dokumentacion urbanistik dhe prova financimi.*
⚠ RREZIK PËR SHKELJE TË INTEGRITETIT	Prokurimi për ekskursion ndahet pa thirrje publike — drejtori "e njeh personalisht" organizatorin dhe "e di se është i besueshëm".	*Kërkesë për procedurë të detyrueshme transparente me minimum tri oferta dhe kritere të shkruara.*

💬 **Pyetje për diskutim**

→ Cila situatë të preku më shumë — dhe pse?

→ A ka ndodhur diçka e ngjashme në shkollën tënde? Si reaguat?

→ Kur rregullat vlejnë vetëm për disa nxënës — çfarë mesazhi u dërgon kjo të tjerëve?

→ A do të thotë trajtimi i barabartë vetëm rregulla të njëjta, apo edhe mundësi e barabartë që rregullat të kuptohen dhe përdoren?

→ Çfarë lloj guximi kërkohet për të reaguar? A mundemi gjithmonë vetëm?

Heshtja është pjesë e problemit. Biseda është fillimi

4 INTEGRITETI AKADEMIK

Integriteti akademik përfaqëson përkushtimin ndaj ndershmërisë, përgjegjësisë, besimit, drejtësisë dhe respektit në procesin e të mësuarit. Kjo nuk është vetëm rregull për faktin që nuk guxon të kopjosh — ky është një sistem vlerash që e përcakton kuptimin e arsimit.

Diploma e fituar përmes kopjimit të testeve dhe provimeve NUK përfaqëson dije. Certifikata e blerë online NUK përfaqëson kompetencë. Vlera e vetme e arsimit është në procesin — në përpjekjen, në gabimet, në të mësuarit. Kur ky proces kompromentohet, arsimi humb kuptimin..

> Hulumtimi i Analytica-s tregoi se 30% e të rinjve kanë qenë dëshmitarë të blerjes së diplomave dhe certifikatave. Kjo nuk është statistikë — është mesazh: sistemi është nën presion.

4.1 Format e shkeljes së integritetit akademik

Shkelje e integritetit akademik përbën çdo sjellje që kompromenton procesin e ndershëm të vlerësimit dhe fitimit të dijes:

Forma	Përshkrimi
Kopjimi	Kopjimi i përgjigjeve të një nxënësi tjetër gjatë testit apo provimit, me ose pa dijeninë e tij.
Plagjiatura	Paraqitja e punës, tekstit apo ideve të dikujt tjetër si të veta — pa cituar burimin.
Mjete të palejuara	Përdorimi i shënimeve, telefonit, pajisjes apo materialit tjetër që nuk lejohet gjatë testimit.
Blerja e punimeve	Porositja apo blerja e punimeve seminarike, eseve apo detyrave që pastaj dorëzohen me emrin e vet.
Keqpërdorimi i inteligjencës artificiale	Përdorimi i mjeteve të IA-së për të gjeneruar tërësisht një detyrë pa kuptuar përmbajtjen, kur mësimdhënësi e ka ndaluar këtë.

Forma	Përshkrimi
Paraqitja e rreme	Dhënia e testit në vend të dikujt tjetër, ose kërkesa që dikush tjetër ta japë testin në vendin tënd.
Blerja e notave / diplomave	Pagesa e mësimdhënësit apo institucionit për notë apo diplomë — formë e rëndë e korrupsionit.

4.2 Temë e veçantë: Inteligjenca Artificiale (IA) dhe integriteti akademik

Zhvillimi i inteligjencës artificiale krijoi një kategori të re dilemash në arsim. Përdorimi i mjeteve të IA-së nuk është automatikisht shkelje e integritetit akademik — varet nga MËNYRA se si përdoret..

Forma	Përshkrimi
I pranueshëm	Përdorimi i IA-së për hulumtim, kërkim burimesh, kontroll gramatike, marrje idesh — me kusht që nxënësi vetë ta shkruajë dhe ta kuptojë detyrën.
Zonë kufitare	Parafrazimi i tekstit të gjeneruar nga IA, me mbindërtim të konsiderueshëm personal — duhet të deklarohet.
I papranueshëm	Dorëzimi i tekstit tërësisht të gjeneruar nga IA me emrin e vet, pa kuptim apo mbindërtim — kur mësimdhënësi e ka ndaluar këtë.
Rekomandim	Mësimdhënësit duhet të kenë rregulla të qarta për përdorimin e IA-së: nëse lejohet, për cilat detyra dhe nën cilat kushte.

> IA nuk është mashtrim kur përdoret transparent.
>
> IA është mashtrim kur përdoret për të fshehur mungesën e dijes dhe të kuptuarit.

4.3. Mësime për orë mësimore

Mësimi 1: A është mashtrim?

Skenarët në vijim janë menduar për diskutim në orë. Për secilin skenar pyetet: a përbën shkelje të integritetit akademik? Pse?

Skenari	Situata
Skenari A	Marko e ka pyetur ChatGPT-në për temën e esesë, ka marrë ide dhe strukturë, e pastaj vetë e ka shkruar tekstin me fjalët e veta.
Skenari B	Ana ka kopjuar tërë esenë nga ChatGPT, ka ndryshuar vetëm disa fjalë dhe e ka dorëzuar.
Skenari C	Lena e ka gjetur esenë në internet, e ka parafrazuar dhe nuk i ka cituar burimet.
Skenari D	Gorani ka kopjuar nga shoku i klasës gjatë testit, ndërsa shoku vullnetarisht i ka lejuar të kopjojë.
Skenari E	Nina ka blerë një punim seminarik online dhe e ka dorëzuar pa ndryshime.
Skenari F	Petari ka përdorur bllok shënimesh gjatë testit kur kjo nuk lejohej, por nuk ka shikuar në të.

Përgjigjet (për diskutim):

A — nuk është shkelje (IA si mjet, vetë shkruan).
B — shkelje (zëvendësim total i punimit).
C — shkelje (plagjiaturë pa citim).
D — shkelje (kopjim).
E — shkelje e rëndë (blerje punimi)..
F — situatë kufitare (qëllimi është i rëndësishëm)..

Mësimi 2: Presioni, grupi dhe heshtja

Skenarët më poshtë e eksplorojnë rolin e grupit, heshtjes dhe presionit shoqëror në shkeljen e integritetit akademik. Për secilin skenar shtrohen pyetjet: a përbën shkelje të integritetit? Pse?

Skenari	Situata	Vlerësimi
Skenari A	E gjithë klasa e di se Ivani shet detyra shtëpie nga matematika — për 200 denarë për detyrë. Mësimdhënësi nuk e di. Askush nuk ka sinjalizuar.	⛔ Shkelje
Skenari B	Para testit, Sara i fotografon shënimet e shoqes së klasës dhe i dërgon në chat-in e grupit — vetëm si përkujtim.	⛔ Shkelje
Skenari C	Mësimdhënësi mungon. Nxënësi i caktuar duhet ta ruajë rendin gjatë provimit me shkrim. Në vend të kësaj, shikon nga ana tjetër.	⚠ Kufitare
Skenari D	Matura po afrohet. Toni gjen në internet një punim të vjetër seminarik nga i njëjti lëndë, i ndryshon emrat dhe datën dhe ia dorëzon mësimdhënëses.	⛔ Shkelje
Skenari E	Ema e ka pyetur nënën e saj (profesoreshë historie) ta ndihmojë të strukturojë temën për punim hulumtues. Nëna i ka dhënë udhëzime — Ema vetë e ka shkruar punimin.	✓ E pranueshme
Skenari F	Mësimdhënësi për çmimin e esesë më të mirë i ka pyetur nxënësit të votojnë — por disa nxënës kanë organizuar votim të koordinuar për një shok që nuk është më i miri.	⛔ Shkelje
Skenari G	Luka e ka përdorur ChatGPT-në për të përkthyer një tekst nga anglishtja, e ka lexuar dhe e ka parafrazuar me fjalët e veta. Ka deklaruar: Përkthyer me ndihmën e IA-së.	✓ E pranueshme

💡 Përgjigjet — për diskutim me mësimdhënësin

A —Shkelje: shitja e detyrave është formë korrupsioni në arsim. Heshtja e klasës është bashkëfajësi..

B — Shkelje: chat-i i grupit nuk është "ndihmë" — është kopjim i organizuar.

C — Kufitare: nxënësi i caktuar nuk është kryesi, por është bashkëpërgjegjës për mjedisin. Mosvërejtja e qëllimshme është formë lejimi..

D — Shkelje: plagjiaturë me autorizim të rremë. Punim i vjetër + emër i ndryshuar = mashtrim.

E — E pranueshme: prindi ka dhënë udhëzim metodologjik, nxënësja vetë e ka krijuar punimin. Kjo është mbështetje legjitime.

F — Shkelje: manipulim i një procesi që duhet të jetë i drejtë dhe i pavarur.

G — E pranueshme: përdorim transparent i IA-së me mbindërtim personal dhe citim — pikërisht ashtu duhet.

💬 Pyetje për diskutim pas mësimit

→ Pse heshtim kur e dimë se dikush mashtron? Ku është kufiri mes besnikërisë dhe bashkëfajësisë?

→ Nëse të gjithë bëjnë diçka, a do të thotë kjo automatikisht se ajo gjë duhet arsyetuar dhe pranuar si sjellje e pranueshme, edhe pse është e parregullt? Kush në të vërtetë humb kur sistemi është plot mashtrime?

→ Nëse mësimdhënësi nuk e di për një situatë të caktuar nga e cila nxënësit kanë përfituar oportunisht — a do të thotë kjo se nuk ka dëm prej saj? Kush dëmtohet?

→ Cila është dallimi mes marrjes së ndihmës dhe dikush që e bën diçka në vendin tënd?

Mësimi 3: Kur institucioni gabon

Shkelja e integritetit akademik nuk vjen vetëm nga nxënësit. Ndonjëherë vetë sistemi krijon kushte për padrejtësi. Për secilin skenar shtrohen pyetjet: a është e pranueshme? Kush është përgjegjës?

Nxënësi nuk është i vetmi aktor. Mësimdhënësit, drejtorët dhe këshillat shkollore gjithashtu mbajnë përgjegjësi për integritetin akademik — ose për shkeljen e tij.

Skenari	Situata	Vlerësimi
Skenari A	Mësimdhënësi çdo vit jep të njëjtat teste — nxënësit i mbledhin dhe i shkëmbejnë pyetjet. Ai e di, por nuk i ndryshon.	⚠ Kufitare
Skenari B	Drejtori e detyron mësimdhënësin ta përmirësojë notën e një nxënësi para fundit të vitit, që të mos bjerë mesatarja e notave e klasës.	⛔ Shkelje
Skenari C	Mësimdhënësja e gjuhës maqedonase i ka vlerësuar të gjitha eseiet njësoj, edhe pse cilësia ndryshonte, sepse nuk ka dashur konflikte me prindërit.	⛔ Shkelje
Skenari D	Shkolla ka futur rregull: çdo nxënës duhet të blejë një libër të caktuar. Autori i librit është mësimdhënës në të njëjtën shkollë.	⛔ Shkelje

Skenari E	Mësimdhënësi jep kritere të qarta vlerësimi para çdo testi dhe i publikon në tabelën e njoftimeve. I njëjti kriter për të gjithë.	✓ E pranueshme
Skenari F	Nxënësi paraqet ankesë për notën. Këshilli i Mësimdhënësve formon komision, e shqyrton punën dhe jep përgjigje me shkrim brenda 5 ditësh.	✓ E pranueshme

💡 Përgjigjet — për diskutim me mësimdhënësin

A — Kufitare: mësimdhënësi nuk është drejtpërdrejt fajtor, por me pasivitet krijon kushte për shkelje. Përgjegjësia është pjesë e rolit.

B — Shkelje: drejtori ushtron presion mbi mësimdhënësin — ky është korrupsion i mesëm. Mesatarja e klasës në asnjë mënyrë nuk guxon të jetë mbi integritetin.

C — Shkelje: shmangia e konfliktit me vlerësim jo të drejtë kompromenton mbarë sistemin e vlerave.

D — Shkelje: konflikt interesi + presion komercial. E lidhur me shembujt nga Pjesa II, seksioni D.

E — E pranueshme: kriteret transparente janë themel i integritetit akademik. Kështu duhet.

F — E pranueshme: procedurë formale dhe e drejtë ankese është integritet institucional në veprim.

💬 Pyetje për diskutim pas mësimit

→ Pse institucionet ndonjëherë "shikojnë nga ana tjetër"? Çfarë presioni ndiejnë mësimdhënësit dhe drejtorët?

→ Kur sistemi shpërblen mashtrimin (me nota më të mira, mesatare më të mirë) — cilat mesazhe u dërgon nxënësve?

→ Çfarë rregullash do të vendosnit ju nëse do të ishit drejtor i shkollës?

→ A keni parë ndonjëherë mësimdhënës që vepron drejtësisht edhe nën presion? Pse është kjo e rëndësishme?

Mësimi 4: Dimensioni gjinor — Kush do ta përfaqësojë shkollën?

Shkolla duhet të zgjedhë dy nxënës për pjesëmarrje në garën e robotikës. Elena dhe Marko kanë rezultate pothuajse të njëjta, ndërsa Elena ka edhe më shumë përvojë praktike. Mësimdhënësi e zgjedh Markon me arsyetimin: „Djemtë zakonisht ia dalin më mirë me teknikën, ndërsa Elena mund të ndihmojë në përgatitjen e prezantimit.""

💬 Pyetje për diskutim

→ A është zgjedhja bërë sipas kritereve të qarta dhe objektive?

→ A ka ndikuar stereotipi gjinor në vendim?

→ Si duhej të zbatohej zgjedhja?

→ Çfarë mund të bëjë Elena nëse mendon se është lënë padrejtësisht anash?

💡 Reagimi i rekomanduar

Shkolla duhet paraprakisht të përcaktojë kritere të qarta dhe të matshme për zgjedhje, si njohuria, rezultatet, përvoja, motivimi dhe puna në ekip. Gjinia nuk guxon të jetë kriter formal apo joformal për vendimmarrje

Mësimi 5: Nxënës me aftësi të kufizuar — Ekskursion për të gjithë?

Shkolla organizon ekskursion njëditor. Petari përdor karrocë me rrota dhe dëshiron të marrë pjesë së bashku me shokët e klasës. Kujdestari i klasës u thotë prindërve të tij: „Është më mirë Petari të mos vijë, sepse vendi nuk është i qasshëm dhe prania e tij do ta vështirësojë organizimin." Shkolla nuk ka shqyrtuar lokacion tjetër, transport të përshtatur apo mbështetje shtesë.

💬 Pyetje për diskutim

→ A ka marrë Petari mundësi të barabartë për pjesëmarrje?
→ A është vështirësia organizative arsye e mjaftueshme që nxënësi të përjashtohet?
→ Çfarë duhej të bënte shkolla para se të merrte vendimin?
→ Kujt mund t'i drejtohen Petari dhe prindërit e tij?

💡 Reagimi i rekomanduar

Shkolla duhet të identifikojë me kohë përshtatjet e nevojshme dhe të zgjedhë lokacion të qasshëm, transport të përshtatshëm ose një mënyrë tjetër të arsyeshme mbështetjeje. Përjashtimi i nxënësit nuk guxon të jetë zgjidhja e parë dhe më e lehtë..

📌 Mesazhi kyç

Mundësitë e barabarta nuk do të thotë që çdo nxënës merr trajtim identik, por se çdo nxënës merr mbështetjen që i nevojitet për pjesëmarrje të barabartë..

Mësimi 6: Nxënës social-vulnerabël — Vizitë në ngjarje kulturore

Shkolla organizon vizitë me pagesë në një ngjarje kulturore. Nxënësve që nuk mund ta paguajnë shumën e nevojshme u kërkohet të qëndrojnë në shkollë, ndërsa emrat e tyre lexohen para tërë klasës..

💬 Pyetje për diskutim

→ A e ka mbrojtur shkolla privatësinë dhe dinjitetin e nxënësve?
→ A krijon gjendja financiare e familjes mundësi të pabarabartë për pjesëmarrje?
→ Si mund të organizohej aktiviteti pa veçim publik të nxënësve?
→ A disponon shkolla një fond apo mekanizëm tjetër mbështetjeje?

Reagimi i rekomanduar

Gjendja financiare e familjes duhet të trajtohet konfidencialisht. Shkolla duhet të parashohë mekanizma solidariteti, përjashtim nga pagesa apo mbështetje tjetër, pa shënim publik dhe poshtërim të nxënësit

4.4. KUIZ PËR NXËNËS: PROVO NJOHURITË E TUA: A ËSHTË KORRUPSION?

Për secilën situatë vendos: A) Korrupsion B) Nuk është korrupsion C) Nuk jam i/e sigurt — dhe arsyeto në 2 fjali pse. Ky fletë pune mund të kopjohet dhe të përdoret drejtpërdrejt në orë.

Situata	Përshkrimi
Situata 1	Mësimdhënësi i Petarit i ka thënë para testit se një pyetje e caktuar nuk do ta ketë testin — babai i tij është mik i ngushtë i mësimdhënësit.
Situata 2	Nëna e Sarës ka sjellë lule për mësimdhënësen për 8 Mars dhe nuk ka kërkuar asgjë në këmbim.
Situata 3	Drejtori e ka emëruar Harisin kryetar të këshillit të nxënësve pa zgjedhje dhe pa kritere.
Situata 4	Mësimdhënësi i ka dhënë një pikë shtesë një nxënësi që ka bërë një pyetje të shkëlqyer në orë.
Situata 5	Prindi e ka thirrur mësimdhënësin dhe ka kërkuar t'i ndryshojë notat e fëmijës.

Përgjigjet:

1 → Korrupsion (favorizim, zbulim paraprak i testit).
2 → Korrupsion i bardhë (shoqërisht i tolerueshëm, pa kërkesë kundërvlere).
3 → Korrupsion (institucional, mbytje e demokracisë).
4 → Nuk është korrupsion (zgjedhje pedagogjike transparente, jo interes personal).
5 → Korrupsion (presion i drejtpërdrejtë për ndryshim note).

4.5 KUIZ PËR NXËNËS: KONTROLL I INTEGRITETIT: Sa integritet ka shkolla juaj

Për secilën pyetje: PO = 2 pikë, PJESËRISHT = 1 pikë, JO = 0 pikë. Qëllimi nuk është të gjenden fajtorë — por të identifikohen mundësi për përmirësim.

A. Drejtësia dhe trajtimi i barabartë

- *A zbatohen rregullat njësoj për të gjithë nxënësit?*
- *A vlerësohen nxënësit sipas kritereve të njëjta?*
- *A i shpjegojnë mësimdhënësit rregullisht kriteret e vlerësimit?*
- *A ekzistojnë mekanizma ankese për vlerësim të padrejtë?*
- *A ekziston politikë kundër favorizimit dhe diskriminimit?*
- *A kanë nxënësit me aftësi të kufizuar dhe ata social-vulnerabël qasje të barabartë në të gjitha aktivitetet?*

B. Vendimmarrja e drejtë

- *A i kanë marrë të gjithë nxënësit informacionin me kohë në gjuhën që e kuptojnë?*
- *A kanë ndikuar stereotipet gjinore apo rolet gjinore në zgjedhje?*
- *A ka marrë nxënësi me aftësi të kufizuar përshtatje adekuate?*
- *A ka ndikuar gjendja financiare apo familjare e nxënësit në mundësinë e tij për pjesëmarrje?*
- *A e vendos vendimi drejtpërdrejt apo tërthorazi një grup të caktuar nxënësish në pozitë më të pafavorshme?*
- *A mund ta arsyetojmë publikisht dhe me argumente vendimin?*

C. Transparenca

- *A dinë nxënësit se si merren vendimet e rëndësishme?*
- *A janë kriteret për zgjedhjen e nxënësve për gara publikisht të disponueshme?*
- *A informohen rregullisht prindërit për politikat shkollore?*
- *A i publikon shkolla informacionet transparent?*
- *A janë nxënësit të informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre?*

D. Pjesëmarrja dhe sinjalizimi

- *A mblidhet rregullisht këshilli i nxënësve dhe a ka rol real?*
- *A dinë nxënësit kujt t'i drejtohen nëse shohin diçka të padrejtë?*
- *A ekziston kuti anonime ankesash e vendosur në vend të dukshëm?*
- *A dini për KSHPK-në dhe aplikacionin Zëri kundër korrupsionit?*
- *A ka marrë përgjigje nxënësi që ka dorëzuar ankesë?*

E. Integriteti i mësimdhënësve

- *A i zbatojnë mësimdhënësit konsistentisht rregullat për të gjithë?*
- *A shmangin mësimdhënësit ofrimin e orëve private tek nxënësit e tyre?*
- *A ekziston politikë e qartë për konfliktin e interesit?*
- *A diskutojnë mësimdhënësit hapur për temën integritet?*
- *A nuk është ankuar asnjë nxënës për trajtim jo të drejtë në vitin e fundit shkollor?*

Pikët	Niveli	Rekomandimi
42–50 pikë	Nivel i lartë	Shkolla juaj është shembull i mirë. Ndani praktikat!
30–41 pikë	Nivel mesatar	Bazë e mirë. Hartoni plan veprimi për fushat e dobëta.
0–29 pikë	Nevojiten përmirësime	Formoni grup pune dhe përgatitni plan për 12 muaj.

Mbaje mend

📌 **Mbaje mend**

✓ Integriteti akademik nuk është vetëm rregull — ai është kuptimi i vetë arsimit..

✓ IA nuk është mashtrim kur përdoret transparent. Mashtrim është kur përmes IA-së fshihet mosdija.

✓ Heshtja e nxënësve kur dikush mashtron është formë bashkëfajësie.

✓ Çdo nxënës mund të kontribuojë — me reagim, jo vetëm me shmangie.

PJESA III
KORNIZA INSTITUCIONALE

Kjo pjesë është thelbi i inovacionit të këtij Doracaku: mekanizma institucionalë konkretë dhe të përhershëm që e dallojnë këtë model nga aktivitetet e deritanishme. Këtu paraqiten Personi për Integritet, Kodi për Dhuratat dhe sistemi i mbrojtjes së sinjalizuesve..

5 PERSONI PËR INTEGRITET NË SHKOLLË

Në çdo shkollë ekziston dikush te i cili nxënësit kanë besim — pedagogu, mësimdhënësi i historisë, sekretarja. Sistemi 5 Yje e shndërron këtë marrëdhënie natyrore në rol zyrtar me detyrime të qarta..

Ndërtimi i kulturës së integritetit në shkollë nuk mund të jetë rezultat i aktiviteteve të veçuara apo projekteve të rastësishme. Nevojitet një qasje sistematike dhe një person qartë i përcaktuar që do ta koordinojë parandalimin, do të jetë pikë besimi dhe do të sigurojë vazhdimësi në aktivitetet e lidhura me integritetin dhe parandalimin e korrupsionit.

Në sistemet arsimore bashkëkohore njihet gjithnjë e më shumë nevoja që çdo institucion arsimor të ketë një person apo koordinator të ngarkuar me çështjet e integritetit, etikës, transparencës dhe denoncimit të parregullsive. Kjo nuk është funksion i ri — është mbindërtim i roleve ekzistuese në shërbimin profesional të shkollës.

> **Personi për Integritet nuk është inspektor. Nuk ndëshkon. Nuk heton**
> Kjo është pikë e sigurt për bisedë, mbështetje dhe parandalim..

5.1 Kush mund të jetë Person për Integritet?

Person për Integritet mund të jetë çdo i punësuar në shkollë që zotëron integritet të lartë personal dhe profesional, gëzon besimin e nxënësve, prindërve dhe kolegëve, dhe është i gatshëm të kujdeset për këtë rol. Personi emërohet me vendim të drejtorit të shkollës.

Profili	Vërejtje
Pedagog / psikolog	Vazhdimësi natyrore e shërbimit ekzistues profesional. Opsion i rekomanduar — tashmë ka besimin e nxënësve.
Punonjës social	Veçanërisht i dobishëm në mjedise me rrezik socio-ekonomik më të lartë.
Mësimdhënës	Nëse shërbimi profesional nuk ekziston ose është i kufizuar. E rëndësishme: nuk guxon të jetë mësimdhënës i lëndës për të cilën sinjalizohet parregullsi.
Bashkëpunëtor profesional	Person me specializim në fushën e të drejtave të fëmijës, parandalimit apo ndërmjetësimit.
I punësuar tjetër	Çdo i punësuar me integritet të lartë, sipas zgjedhjes së kolegjiumit dhe miratimit të drejtorit.

5.2 Rolet dhe përgjegjësitë

Personi për Integritet i kryen funksionet e mëposhtme:

Domeni	Detyra	Përshkrimi
Parandalimi	Edukim dhe ndërgjegjësim	Organizon punëtori, ligjërata dhe fushata për integritet me nxënësit dhe mësimdhënësit.
Parandalimi	Identifikimi i rreziqeve	I ndjek situatat që mund të krijojnë rrezik nga sjellje korruptive dhe propozon masa parandaluese.
Mbështetja	Bisedë konfidenciale	Siguron hapësirë të sigurt për nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit që duan të sinjalizojnë apo të bisedojnë për parregullsi.
Mbështetja	Informimi	I informon nxënësit dhe prindërit për mekanizmat e sinjalizimit — të brendshëm dhe të jashtëm.
Koordinimi	Klubi për Integritet	Koordinon punën e Klubit Nxënës për Integritet, e mbështet klubin si mentor.
Koordinimi	Raporti vjetor	Përgatit një raport të shkurtër vjetor (1–2 faqe) për aktivitetet — i dorëzohet drejtorit.
Bashkëpunimi	Institucionet e jashtme	Bashkëpunon me KSHPK, Inspektoratin Shtetëror Arsimor, MASH, BZHA dhe organizata qytetare.

5.3 Çfarë NUK është Person për Integritet?

Personi për Integritet NUK:

× nuk është inspektor — nuk zbaton procedura disiplinore
× nuk është sinjalizues — nuk i dorëzon emrat e nxënësve
× nuk është mbikëqyrës — nuk i ndjek mësimdhënësit
× nuk është zëvendësim për shërbimin profesional — por mbindërtim i tij
× nuk është prokuror — por është ndërmjetës, këshilltar dhe siguron mbështetje

5.4 Kushtet për punë efektive

- *Emërim formal — me vendim të drejtorit, jo vetëm ngarkesë gojore.*
- *Hapësirë e veçantë për biseda konfidenciale.*
- *Kuti anonime ose kanal digjital sinjalizimi pa kontakt të drejtpërdrejtë.*
- *Minimum 2 orë në javë — lirim nga pjesë e detyrave administrative.*
- *Trajnim vjetor — pjesëmarrje në trajnime të KSHPK-së, MASH-it apo organizatave qytetare.*
- *Mbrojtje — drejtori nuk guxon të ushtrojë presion mbi Personin për Integritet.*

5.5 Mbrojtja nga presioni dhe hakmarrja ndaj Personit për Integritet

Personi për Integritet duhet ta kryejë funksionin e tij në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe pa frikë nga pasoja të pafavorshme. Drejtori, organet shkollore, të punësuarit apo persona të tjerë nuk guxojnë të ushtrojnë presion, të pengojnë veprimin sipas sinjalizim apo të ndërmarrin masa hakmarrjeje për shkak të kryerjes së ndërgjegjshme të këtij roli..

Shkolla është e detyruar të sigurojë:

- *konfidencialitetin e informacioneve;*
- *mbrojtje nga veprimi i pajustifikuar disiplinor apo profesional;*
- *mundësi për sinjalizimin e presionit tek Këshilli i Shkollës apo institucioni kompetent;*
- *evidentim dhe dokumentim të çdo veprimi sipas sinjalizimit;*
- *zbatim të rregullave në fuqi për mbrojtjen e sinjalizuesve, kurdo që plotësohen kushtet ligjore.*

Personi për Integritet nuk është organ hetimor dhe nuk përcakton faj. Roli i tij është ta pranojë informacionin, ta vlerësojë kompetencën, të sigurojë konfidencialitet dhe ta drejtojë rastin tek organi shkollor apo institucioni kompetent.

5.6 Propozim: Plani Vjetor i Personit për Integritet

Periudha	Aktiviteti
Shtator	Njohja me nxënësit e rinj. Vendosja e kutisë anonime. Informim për mekanizmat e sinjalizimit.
Tetor	Organizimi i mbledhjes themeluese të Klubit për Integritet. Nënshkrimi i Kartës.
Nëntor	Punëtori tematike me nxënës: Njohja e korrupsionit në jetën e përditshme.
Dhjetor	Takim tematik me prindër (në bashkëpunim me kujdestarët e klasave).
Shkurt	Shqyrtim i sinjalizimeve anonime. Bisedë me drejtuesit për rreziqe eventuale.
Mars	Aksion guerile ose fushatë e Klubit për Integritet.
Prill	Vizitë në KSHPK apo institucion tjetër relevant. Takim me partner të jashtëm.
Maj	Java e Integritetit. Ndarja e Certifikatave për ambasadorë.
Qershor	Përgatitja e raportit vjetor. Vlerësimi i aktiviteteve.

5.7 Vetëvlerësimi i Personit për Integritet

Pyetja	Përgjigja
A organizova të paktën 2 aktivitete edukative në vit?	PO / JO / PJESËRISHT
A dinë nxënësit kujt t'i drejtohen në rast parregullsie?	PO / JO / PJESËRISHT
A ishte kutia anonime e vendosur dukshëm dhe e kontrolluar rregullisht?	PO / JO / PJESËRISHT
A bashkëpunova me Klubin për Integritet?	PO / JO / PJESËRISHT
A dorëzova raport vjetor tek drejtori?	PO / JO / PJESËRISHT
A mora pjesë në të paktën 1 trajnim të jashtëm?	PO / JO / PJESËRISHT

5.8 MËSIM PËR ORË MËSIMORE: KUJT I BESOJMË KUR DIÇKA NUK ËSHTË NË RREGULL?

TEMA: Person për Integritet në shkollë

Kohëzgjatja: 40 minuta | Mosha: 13–18 vjeç | Metodat: Diskutim, studim rasti, punë në grupe, hartim i besimit

Qëllimi i mësimit: Nxënësit të kuptojnë pse është e rëndësishme që në shkollë të ekzistojë Person për Integritet, të njohin kujt mund t'i drejtohen kur vërejnë parregullsi dhe të propozojnë si duhet të funksionojë sistemi i mbështetjes dhe mbrojtjes në shkollën e tyre.

Rezultatet e të mësuarit: Pas përfundimit të aktivitetit, nxënësit do të mund të:

- → shpjegojnë çfarë përfaqëson Personi për Integritet;
- → njohin situata në të cilat nevojitet kërkim mbështetjeje;
- → përmendin kujt mund t'i drejtohen në rast padrejtësie apo dyshimi për korrupsion;
- → propozojnë karakteristika të personit të besuar në shkollë;
- → marrin pjesë në krijimin e sistemit shkollor për integritet.

Aktiviteti hyrës: Kujt do t'i drejtoheshit?

Kohëzgjatja: 5 minuta

Mësimdhënësi u parashtron nxënësve pyetjen:

„Imagjinoni se jeni dëshmitarë të një situate që nuk është e zakonshme dhe që kërkon reagimin tuaj. Kujt do t'i drejtoheshit së pari?"

Çdo nxënës në mënyrë anonime e shkruan përgjigjen e tij në një copë letër. Letrat mblidhen dhe mësimdhënësi lexon disa përgjigje.

Më pas vijon një diskutim i shkurtër:

- Pse e zgjodhët atë person?
- A ndjeni besim?
- Çfarë do të ndodhte nëse ai person nuk mund t'ju ndihmonte?

Aktiviteti 1: Si duhet të jetë Zyrtari i Integritetit?

Kohëzgjatja: 10 minuta

Nxënësit ndahen në grupe të vogla. Secili grup duhet t'i përgjigjet pyetjes së mëposhtme:

"Çfarë cilësish dëshironi që të ketë Zyrtari i Integritetit në shkollën tuaj?"

Çdo grup duhet të zgjedhë pesë karakteristikat më të rëndësishme.

Shembuj: i ndershëm; i paanshëm; i besueshëm; i afrueshëm; i guximshëm; përgjegjës; i drejtë; i komunikueshëm..

Çdo grup paraqet karakteristikat e përzgjedhura.

Mësuesi/ja shkruan karakteristikat e propozuara në tabelë dhe, së bashku me nxënësit, krijon një "Profil të Zyrtarit të Integritetit".

Aktiviteti 2: Studim rasti

Kohëzgjatja: 10 minuta

Ana dhe nota e padrejtë

Ana është nxënëse e shkëlqyer dhe rregullisht arrin rezultate të larta në matematikë. Në testin e fundit ka marrë notën 3. Kur ka kërkuar t'i shohë testin dhe t'i shpjegohet nota, mësimdhënësi është përgjigjur shkurt se nota është përfundimtare dhe se nuk ka nevojë për diskutim shtesë. Disa ditë më vonë, Ana ka dëgjuar nga shokët e klasës se dy nxënëse i kanë ditur paraprakisht pyetjet e testit, sepse prindërit e tyre kanë qenë të afërt me mësimdhënësin. Ana nuk di çfarë të bëjë. Ka frikë se nëse ankohet, mësimdhënësi do të bëhet edhe më i ashpër ndaj saj.

Pyetje për diskutim

- A ka Ana të drejtë të kërkojë shpjegim për notën?
- A ekziston dyshimi për veprim të padrejtë?
- Kujt duhet t'i drejtohet së pari?
- A është i justifikuar frika e Anës?
- Çfarë do të bënit ju në vendin e saj?
- Si do të mund të ndihmonte personi për integritet në këtë situatë?

Aktiviteti 3: Harta e besimit

Kohëzgjatja: 5 minuta

Mësimdhënësi e paraqet në tabelë skemën e mëposhtme:

Nxënësi ↓ Kujdestari i klasës ↓ Pedagogu / Psikologu ↓ Drejtori ↓ Personi për integritet

Nxënësit, me anë të ngjitëseve ose markerëve, shënojnë:

- 🟢 Kujt do t'i besonin më së shumti?
- 🟡 Kujt eventualisht do t'i drejtoheshin?
- 🟡 Kujt nuk do t'i drejtoheshin?

Vijon diskutimi:

- Pse kemi nivele të ndryshme besimi?
- Çfarë mund të bëjë shkolla për ta rritur besimin?
- A do të ishte e dobishme të ekzistonte një person për integritet?

Aktiviteti përmbyllës

Kohëzgjatja: 5 minuta

Mësuesi/ja bën pyetjen e mëposhtme: “A ka ndonjë person në shkollën tonë të cilit nxënësit mund t'i drejtohen në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale kur vërejnë një parregullsi?”

Nxënësit ndajnë mendimet dhe reflektimet e tyre. Në fund, secili nxënës plotëson fjalinë e mëposhtme:

“Një shkollë me integritet është një shkollë ku _____.”

Përgjigjet mund të afishohen në tabelën e njoftimeve të shkollës ose në klasë, si një kujtesë për vlerat që nxënësit duan të promovojnë dhe të forcojnë brenda komunitetit të tyre shkollor.

6 KODI PËR DHURATAT NË SHKOLLË

Dhuratat shpesh përjetohen si shenjë falënderimi dhe ngrohtësie. Megjithatë, kur dhuratat bëhen të shtrenjta, të organizuara apo të lidhura me pritje për shërbim të caktuar, ato mund të krijojnë rrezik konflikti interesi dhe sjellje korruptive.

Problemi nuk është në qëllimin — problemi është në pasojën. Edhe kur nuk ekziston qëllim i drejtpërdrejtë ryshfetdhënieje, dhurata e shtrenjtë krijon detyrim joformal.

> **Nuk ekzistojnë dhurata të këqija. Ekzistojnë dhurata të papranueshme.**
>
> Dallimi nuk është te vlera e qëllimit, por te vlera e sendit dhe konteksti në të cilin jepet.

6.1 Forma të pranueshme falënderimi

Forma	Vërejtje
Urim / letër	Urim i shkruar me dorë apo letër falënderimi.
Vizatim / punë krijuese	Vizatim fëmijësh, poezi apo dhuratë e vogël krijuese.
Send simbolik	Send me vlerë simbolike (nën 500 denarë).
Fotografi e përbashkët	Foto kujtimi nga ora apo ngjarja.
Njohje publike	Lavdërim para klasës apo në takim me prindër.

6.2 Forma të papranueshme

Forma	Pse është problem?
Para — në çfarëdo forme	Dhënie e drejtpërdrejtë parash — përfshirë pagesën për orë private.
Vauçera dhe karta dhuratë	Funksionalisht ekuivalente me paranë.
Bizhuteri apo sende të shtrenjta	Vlerë mbi 2.000 denarë — pavarësisht nëse jepet kolektivisht apo individualisht.
Pajisje elektronike	Telefona, tableta, aplikacione, abonime.
Mbledhje e organizuar parash	Krijon presion social mbi prindërit që nuk duan apo nuk mund të marrin pjesë.
Dhuratë e lidhur me pritje	Çdo dhuratë e dhënë para ose gjatë vlerësimit.

> Rregull praktik: Nëse dhurata nuk do të jepej publikisht, para të gjithë prindërve dhe nxënësve — atëherë ndoshta nuk duhet të jepet fare.

6.3 Detyrimet

Mësimdhënësit:

- *Refuzo dhurata që i tejkalojnë format e pranueshme — me dinjitet.*
- *Mos prano dhurata gjatë periudhave të vlerësimit.*
- *Sinjalizo nëse pëson presion — tek Personi për Integritet.*
- *Ji shembull — nxënësit mësojnë nga ajo që shohin.*

Prindërit:

- *Mos organizo mbledhje kolektive parash për dhurata të shtrenjta.*
- *Mos jep dhurata para apo gjatë vlerësimit.*
- *Shpreh falënderim përmes prezencës, bashkëpunimit dhe mbështetjes.*

6.4 Pyetje të shpeshta

Këto pyetje shtrohen më së shpeshti nga prindërit. Përgjigjet udhëhiqen nga parimi: simbolike dhe pa pritje është në rregull; e shtrenjtë, e organizuar apo e lidhur me vlerësim nuk është.

Pyetja	Përgjigja
A lejohen lule për 8 Mars?	Po. Një lule apo tufë e vogël nga klasa është gjest simbolik, pa pritje kundërvlere.
A lejohet urim i përbashkët?	Po, gjithmonë. Urim, letër apo vizatim nga nxënësit kurrë nuk është problem — përkundrazi, rekomandohet.
A lejohet dhuratë mbi 500 denarë?	Nuk rekomandohet. Mbi pragun prej 500 denarësh tashmë krijon rrezik, veçanërisht nëse jepet individualisht, jo kolektivisht simbolike.
A guxojmë të mbledhim nga 50 denarë për fëmijë për dhuratë të përbashkët?	E pranueshme vetëm nëse vlera e dhuratës përfundimtare mbetet simbolike dhe pjesëmarrja është plotësisht vullnetare, pa presion social.
Çfarë nëse mësimdhënësi refuzon dhuratën — a është kjo fyerje?	Jo. Refuzimi i sjellshëm („Ju falënderoj, por nuk mund të pranoj dhurata") është sjellje profesionale, jo fyerje personale.
A guxojnë nxënësit të bëjnë surprizë për fund të vitit?	Po — aktivitet grupor (fotografi, ekspozitë vizatimesh, letër falënderimi) është gjithmonë i mirëpritur.

Kjo politikë nuk është kundër falënderimit.
Ajo është për mbrojtjen e drejtësisë.

7 MBROJTJA E SINJALIZUESVE

Një nga faktorët më të mëdhenj që i pengon njerëzit të sinjalizojnë parregullsi është frika. Kjo frikë është e arsyeshme nëse nuk ekziston sistem për mbrojtjen e sinjalizuesve.

Hulumtimi i Analytica-s tregoi se më shumë se gjysma (51%) e të rinjve do të sinjalizonin korrupsion nëse ekziston një mekanizëm i sigurt, i besueshëm dhe anonim. Kjo do të thotë se problemi nuk është mungesa e vullnetit. Problemi është mungesa e sigurisë.

Sinjalizimi nuk është tradhti.

Sinjalizimi është përgjegjësi qytetare.
Heshtja për parregullsi është pranim i padrejtësisë.

7.1 Kush është i mbrojtur?

Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve parashikon:

- *Sinjalizuesi nuk mund të largohet nga puna për shkak të sinjalizimit.*
- *Nuk mund t'i ulet paga apo të degradohet.*
- *Nuk mund të ekspozohet ndaj mobingut apo presionit psikologjik.*
- *Identiteti i tij duhet të mbrohet gjatë procedurës.*
- *Mund të paraqesë padi nëse pëson pasoja për shkak të sinjalizimit.*

E RËNDËSISHME:

Mbrojtja ligjore vlen për PERSONAT QË SINJALIZOJNË ME QËLLIM TË MIRË.
NUK VLEN PËR SINJALIZIME TË RREME ME QËLLIM DËMTIMI TË DIKUJT.

7.2 Mekanizmat e brendshëm të sinjalizimit

Kanali	Vërejtje
Personi për Integritet	Kontakti i parë. Konfidencialiteti i garantuar. Gojarisht, me shkrim ose anonim.
Kutia anonime	Kuti fizike në vend të dukshëm. Kontrollohet çdo javë.
Pedagog / psikolog	Shërbimi profesional është i detyruar të reagojë dhe ta mbrojë identitetin.
Drejtori	Për raste më serioze. Përgjigje e detyrueshme me shkrim brenda 8 ditësh.
Aplikacioni: Zëri kundër korrupsionit	100% anonim. Direkt tek Analytica dhe KSHPK. iOS dhe Android.

7.3 Mekanizmat e jashtëm të sinjalizimit

Institucioni	Përshkrimi
KSHPK	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. www.dksk.mk.
Inspektorati Shtetëror Arsimor	Kompetent për shkelje në procesin arsimor.
Ombudsmani	Për shkelje të të drejtave. Mund të paraqitet edhe në emër të dikujt tjetër.
Prokuroria Publike	Për vepra penale (ryshfet, përvetësim).
Sindikata e Pavarur për Arsim, Shkencë dhe Kulturë	Për mësimdhënësit që janë nën presion.
OJQ dhe organizata qytetare	Ndihmë juridike falas dhe vëmendje mediatike.

Hap pas hapi: Kur dhe kujt t'i drejtohesh?

- Hapi 1: Bisedë me Personin për Integritet apo pedagogun.
- Hapi 2: Nëse nuk ka reagim — ankesë me shkrim tek drejtori.
- Hapi 3: Nëse drejtori nuk reagon — sinjalizim tek Inspektorati Shtetëror Arsimor.
- Hapi 4: Për raste serioze — KSHPK, Prokuroria Publike ose mediat.
- Në çdo moment: Aplikacioni Zëri kundër korrupsionit është i disponueshëm 24/7.

PJESA IV
PUNA ME AKTORËT

Kjo pjesë ofron mjete konkrete për çdo grup në bashkësinë shkollore: nxënës, mësimdhënës dhe prindër. Qëllimisht janë përfshirë vetëm aktivitetet më të mira, më të vlefshme, përkatësisht ato me vlerën më të lartë pedagogjike.

8 NGA NXËNËS DERI TE AMBASADOR I INTEGRITETIT

Udhëtimi drejt integritetit nuk është ngjarje e njëhershme — është proces që zhvillohet gjatë gjithë vitit shkollor.

Hapat në rrugën Nga nxënës deri te Ambasador i integritetit

Hapi	Përshkrimi
1. Mëson për integritetin	Orët e Edukatës Qytetare dhe Etikës i vendosin bazat.
2. Ndjek punëtori	Punëtoritë japin mjetet praktike për njohje dhe reagim.
3. Bëhet anëtar klubi	Klubi për Integritet e ndërton bashkësinë dhe e vazhdon aksionin.
4. Organizon aksion	Aksionet guerile dhe fushatat i përhapin mesazhet jashtë klasës.
5. Përdor aplikacionin mobil	Aplikacioni e forcon zërin — anonim, i sigurt, efektiv.
6. Bëhet Ambasador	Certifikata e konfirmon angazhimin. Ambasadori frymëzon të tjerët.

9 MËSIMDHËNËSI SI AMBASADOR I INTEGRITETIT

Nxënësit ndoshta nuk do të mbajnë mend gjithmonë të gjitha mësimet nga mësimdhënësit — por do të mbajnë mend mënyrën se si janë trajtuar prej tyre. Kur mësimdhënësi ka vepruar drejtësisht, kur i ka zbatuar rregullat njësoj për të gjithë fëmijët, kur ka pranuar gabim para tërë klasës etj. Këto momente vlejnë më shumë se dhjetë mësime për integritetin. Edhe ti mund të jesh një mësimdhënës i tillë..

Çfarë të bësh	Çfarë të shmangësh
✓ Zbato kritere të njëjta për të gjithë nxënësit	✕ Favorizim për shkak afërsie personale
✓ Dokumento çdo notë me arsyetim	✕ Nepotizëm — favorizim i të afërmve
✓ Kërko dokumentacion relevant për mungesë	✕ Dorëzim nën presionin e prindërve
✓ Refuzo dhurata mbi vlerën simbolike	✕ Marrëveshje private jashtë kanaleve zyrtare
✓ Bisedo hapur për integritetin në orë	✕ Ofrim orësh private tek nxënësit e vet
✓ Sinjalizo nëse je nën presion	✕ Ndëshkim selektiv

9.1 Dilema reale — Si duhet të veprojë mësimdhënësi?

Dilema 1: Prindi kërkon që mësimdhënësi ta mbyllë syrin për mungesa të pajustifikuara.
Mësimdhënësi: ✓ T'i zbatojë të njëjtat rregulla si për të gjithë nxënësit e tjerë. Pa përjashtim.

Dilema 2: Nxënës me prindër me ndikim kërkon mundësi shtesë për përmirësim note.
Mësimdhënësi: ✓ T'u mundësojë kushte të njëjta për të gjithë nxënësit. E drejta e përmirësimit vlen për të gjithë ose për askënd

Dilema 3: Koleg mësimdhënës kërkon një nder që nuk përputhet me rregullat.
Mësimdhënësi: ✓ Të veprojë sipas procedurave dhe standardeve profesionale. Pa kompromis.

9.2 Mësime për orë mësimore

